



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr.152/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.152/2021 të datës 18.03.2021 të parashtruar nga me adresë banimi Rr." Shaqir Igrishta", Nr.35/3, Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridik "ndërprerje e marrëdhënies së punës dhe kompensim material", pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.152/2021 të datës 18.03.2021 të parashtruara nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ne datë 18.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1231/2021 të regjistruar me A.nr.152/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër vendimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për shkëputjen e Kontratës - Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me Nr.61/25 të datës 04.09.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.03.2021 përmes shkresës me numër protokoli 1333/2021 ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa më datë 02.04.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 152/2021, e datës 18.03.2021, me numër protokoli 1231/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 06.05.2020 të Menaxheres së Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural drejtuar ankuesit për shkëputje të Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta, E-mailin e datës 23.04.2021 nga H.TH për F.M dhe e-mailin e bashkangjitur, Pasqyrën nga TRUSTI për periudhën 01.08.2002, deri me datën 24.08.2020 fq.1/3, Deklaratën nën betim të datës



14.09.2020 të nënkohshme nga ankuesi, Certifikatën e punësimit me nr. 161.11.1.470/19 të datës 16.09.2019, Përgjigjen në ankesë e datës 01.04.2021, me numër protokoll 1591/2021, Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për Vitin 2019, Vendimin nr. 61/26 të datës 04.09.2019, Marrëveshje për Shërbime të Veçanta me numër protokoll 446/3 të datës 04.03.2020, Raport Vjetor i datës 11.12.2019, Vendimin nr. 1955/2 të datës 12.08.2014, ID e ankuesit, Marrëveshje për Shërbime të Veçanta me numër protokoll 1955 të datës 12.08.2014, Marrëveshje për Shërbime të Veçanta me numër protokoll 534/19 datës 28.10.2016, Marrëveshje për Shërbime të Veçanta me numër protokoll 206/10 të datës 27.05.2015, Email i F.M i datës 1.04.2021 për Këshillin me nr. Protokoll 1591.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesi nga data 01.07.2014 e tutje ka lidhur Marrëveshje mujore për Shërbime të Veçanta me Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për kryerjen e detyrave të punës së Zyrtarit të Lartë për Trajnime dhe Ndërtimin e Kapaciteteve " në Divizionin për Informim, Bashkëpunim, Monitorim dhe Trajnim.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 06.05.2020 ka shkëputur në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta, me ankuesin me arsyetimin e mungesës së bazës ligjore si dhe shkurtimeve buxhetore. Kundër vendimit për shkëputje të Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës më datë 08.03.2021 me pretendimet ankimore se shkëputja e Kontratës/Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me Nr.61/25 të datës 04.09.2019 ka qenë e kundërligjshme dhe së bazuar në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë nenin 83 paragrafi 2, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është dashur që ankuesit ti lëshoj Akt Emërim për pozitën e Zyrtarit të Lartë për Trajnime dhe Ndërtimin e Kapacitete në Divizionin për Informim, Bashkëpunim, Monitorim dhe Trajnim, sepse ai ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Me tej, ankuesi shton se MBPZHR për periudhën kohore nga data 01.07.2014 deri me 19.04.2016 nuk i ka paguar ankuesit kontributet pensionale edhe pse ka punuar gjatë kësaj periudhe çka dhe vërtetohet edhe me vet Vërtetimin e lëshuar nga MBPZHR të datës 16.09.2019. Propozon që Këshilli ta kthejë në vendin e tij të Zyrtarit të Lartë për Trajnime dhe Ndërtimin e Kapacitete si dhe të detyroj MBPZHR që ti kompensojë kontributet pensionale për përdhën nga 01.07.2014 deri me 19.04.2016.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me këtë çështje ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 12 ku përcaktohet se: *1. Në Shërbimin Civil të Kosovës ekzistojnë dy kategori të punësuarve: 1.1. pozitë e nëpunësve civilë të karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme për arritjen e objektivave të përgjithshme institucionale; dhe 1.2. pozitë e nëpunësve civilë të jo karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy (2) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civilë dhe në raste të mbingarkesave në punë"* dhe si rrjedhojë ka konstatuar se të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nuk hyjnë në asnjërën nga këto dy kategori të të punësuarve në Shërbimin Civil. Po ashtu duke ju referuar nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji ka konstatuar se të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta i nënshtrohen dispozitave të Ligjit për Detyrimet, respektivisht nuk kanë statusin e nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave këtë konstatim e mbështet edhe në Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.26/2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili ndër të tjera konstaton se organi i paditur në këtë rast Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vepruar drejt kur ka shpallur



veten jo kompetent për shqyrtimin e ankesës nga tani në kategorinë e të punësuarve me konuata konsulente (marrëveshje për shërbime të veçanta), nuk bëjnë pjesë në dy kategoritë e të punësuarve në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për praninë në Shërbimin civil, si dhe duke marrë parasysh konstatimin se të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nuk kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr.152/2021

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivot të KPMSHCK-së

